

UDHËZIM PËR VLERËSIM

VËREJTJE: Gabimet në gramatikë duhet anashkaluar, vetëm nëse është qëllimi i detyrës kontrollimi i rregullës së caktuar gramatikore ose drejtshkrimore.

DETYRA 1: Nxënësi/nxënësja* merr **1 pikë** nëse ka rrethuar numrin: 4. me fotografi

DETYRA 2: gjithsej **2** pikë:

Nxënësi merr 2 pikë nëse ka shkruar 2 të dhëna nga:

- futbollit është loja për masat e gjëra popullore;
- pasioni për futbollin e kapërcen varfërinë;
- një top mund ta bëjë të lumtur "një fshat të tërë";
- topat janë bërë nga materialet e ndryshme.

Vërejtje: Nxënësi merr 2 pikë edhe nëse të dy të dhënat i shkruan mbi një vijë.

Nxënësi merr 1 pikë nëse ka shkruar vetëm një të dhënë.

Nxënësi merr zero pikë nëse shkruan një të dhënë të parëndësishme.

DETYRA 3: nxënësi merr **1 pikë** nëse ka: Rrethuar JO dhe ka argumentuar:

Xhesika në vitin 2010 ka shkruar në Afrikë që të shohë se si duket futbollit larg nga reflektorët e ndritshëm dhe stadiumeve të mëdha/JO.

Në vitin 1862 në Afrikë janë luajtur ndeshjet në Kejpotaun dhe Port Elizabeth./JO. Xhesika në Afrikë kishte qenë në vitin 2010., dhe jo në vitin 1862./JO. Xhesika as që ka pas lindur në vitin 1862. (dhe përgjigje të tjera të ngjashme)

Vërejtje:

1. Nxënësi merr 1 pikë nëse ka argumentuar saktë, por nuk ka rrethuar as PO dhe as JO.
2. Nxënësi merr 0 pikë nëse ka rrethuar PO ose edhe PO edhe JO pa marrë parasysh në saktësinë e argumentimit.

DETYRA 4: është rrethuar numri 2 – Janë të pashoq sepse i bëjnë fëmijët nga materialet e ndryshme.

1 pikë

*Në tekstin e mëtejshëm nxënësi

GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI
KONTROLLIMI EKSTERN I DIJES NË FUND TË CIKLIT III TË SHKOLLËS FILLORE
PRILL, VITI MËSIMOR 2023-2024

DETYRA 5: nxënësi merr **1 pikë** për përgjigje plotësisht të saktë:

POHIMI	SAKTË	PASAKTË
Ai mbikëqyr ekipet e të rinjve në Ganë.	S	P
Ai përpiket që të rinjtë t'i bëjë me përgjegjësi shoqërore.	S	P
Ai thotë se futbolli është një pasion i të gjithë njerëzve në botë.	S	P

DETYRA 6: gjithsej **3 pikë** nëse ka plotësuar tabelën:

Përshkrimi i personazhit	Emri i personazhit	Titulli i veprës
I ri, i shkolluar jashtë Shqipërisë që kthehet në atdhe, në qytetin e lindjes, me idealin për të dhënë kontributin e tij si shkrimtar dhe për të ndërtuar një të ardhme më të mirë për vendin e tij.	<i>Hilush Vilëza</i>	<i>Tregtar flamujsh</i>
E bija e Prenkë Vukës që mishëron tiparet më të larta dhe më të bukura të vajzës shqiptare.	<i>Nita</i>	<i>Nita</i>
Vuan nga dashuria për të bijat, të cilat nuk e përfillin as në shtratin e vdekjes.	<i>Xha Gorio</i>	<i>Honore de Balzak</i>

Nxënësi merr **2 pikë** për dy tituj të veprës të shkruar saktë dhe autorët e tyre.

Nxënësi merr **1 pikë** për një titull të veprës të shkruar saktë dhe autorin e saj.

DETYRA 7: gjithsej **2 pikë**:

- A) nxënësi merr **1 pikë** nëse ka rrethuar numrin 2- *statik*
- B) nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar p.sh. Fragmenti fillon me përshkrimin e Harryt./ Përshkrimet ngadalësojnë veprimin dhe për këtë arsye është motivi statik./Portreti (dhe përgjigje të tjera të cilat tregojnë për përshkrim ose ngadalësim të veprimit)

GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI
KONTROLLIMI EKSTERN I DIJES NË FUND TË CIKLIT III TË SHKOLLËS FILLORE
PRILL, VITI MËSIMOR 2023-2024

DETYRA 8: nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar: *shtëpia e Darslëve/shtëpia e teze Petunias/kuzhina e teze Petunias dhe tezakut Vernon, Londër (përgjigja ka të bëjë me njohjen e tërësishme të veprës dhe përgjigje të tjera të cilat tregojnë në shtëpinë ose kuzhinën e Darslëve)*

DETYRA 9: nxënësi merr **1 pikë** nëse rrethon numrin 1 – tezaku Vernon dhe citon fjalitë nga teksti: Krihu! - bërtiti ai në vend të një përshëndetjeje mëngjesi; Tezaku bërtiste se Harry kishte nevojë për një prerje flokësh ose jep argumentin se përse tezaku Vernon sillet keq me Herryt etj.

Vërejtje:

1. Nxënësi merr 1 pikë nëse nuk ka rrethuar numrin para përgjigjes së saktë, por ka argumentuar saktë.
2. Nxënësi merr 0 pikë nëse:
 - përgjigjja e rrethuar nuk i përgjigjet argumentimit të shkruar
 - ka rrethuar përgjigjen, por nuk ka shkruar argumentimin
 - ka rrethuar të dy numrat pa marrë parasysh në saktësinë e argumentimit

DETYRA 10: gjithsej **2 pikë:**

Dëshmia 1 – përgjigjet që kanë të bëjnë me fjalinë: *Ai mbante syze të rrumbullakëta të fiksuara me shumë ngjitëse, gjë që ishte një kujtim i shumë herëve që Dudley e godiste në hundë (dhe përgjigje të ngjashme).*

- 1 pikë

Dëshmia 2 - përgjigjet që kanë të bëjnë me fjalinë: *Harry thoshte se Dudley dukej si një derr me parukë* - **1 pikë**

Vërejtje:

1. Nxënësi merr **2 pikë** nëse në kuadër të një dëshmie shkruan se *Harry ka mundur të ndjejë furtunën të cilën Dudley e përgatiti sepse disa herë e ka shkundur nga hunda.*
2. Rënenditja e dëshmimeve nuk ndikon në saktësi.

Nxënësi nuk merr pikë/pikët nëse shkruan një përgjigje të Parëndësishme e cila ka të bëjë me karakterin e Dadleyt e jo me raportin e Harryt dhe Dadleyt, p.sh.:

1. *Harry shtron tavolinën derisa Dadley numëron dhuratat.*
2. *Harry me gllabërim hante proshutën për shkak të frikës se Dadley do ta rrotullonte tavolinën.*
3. *Teze Petunia parandiente rrezikun.*

GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI
KONTROLLIMI EKSTERN I DIJES NË FUND TË CIKLIT III TË SHKOLLËS FILLORE
PRILL, VITI MËSIMOR 2023-2024

DETYRA 11: gjithsej **2 pikë**

Nxënësi merr **2 pikë** nëse përgjigjja tregon për një të kuptuar të plotë të tekstit dhe shkruan disa nga tiparet:

nervozizëm/shqetësim/histerizëm/impulsivitet...(dhe tipare të ngjashme të cilat tregojnë për një sjellje të pashembullt dhe të vrazhdë)

Nxënësi merr **1 pikë** nëse përgjigjja tregon që e ka kuptuar tekstin të orientuar vetëm të numrit të dhuratave, përkatësisht përmend ndonjë nga tiparet si: të budallallëkut/mendjelehtësisë/lakmisë...)

Nxënësi merr **0 pikë** nëse shkruan një përgjigje të parëndësishme.

DETYRA 12:

Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar, p.sh.: Është mësuar që të tjerët t'ia zgjidhin problemet e tija./Nuk është i mençur/Ai është i lazdruar./Nuk mendon, mamaja dhe babai punojnë në vend të tij. (dhe përgjigje të tjera të cilat tregojnë për mendimin dhe paditurinë e tij)

DETYRA 13: është rrethuar numri 4 – i shkëmbente
1 pikë

DETYRA 14: gjithsej **2 pikë:**

- A) Nxënësi merr **1 pikë** për përgjigje plotësisht të saktë:
ndeshja – emërorja
ne – emërorja
mosmarrëveshjet – kallëzorja
- B) Nxënësi merr **1 pikë** nëse shkruan, p.sh.: Fjalitë janë në inversion./Fjalja e varur është në vendin e parë, kurse fjalja kryesore në vendin e dytë. Fjalja kohore është e para, kurse kryesorja e dyta.

DETYRA 15: gjithsej **2 pikë** nëse nxënësi ka shkruar saktë të gjitha format mohuese të fjalëve të dhëna:

Fjala	Forma mohuese
pranim	<i>mospranim</i>
sukses	<i>mossukses</i>
gjësend	<i>asgjësend</i>

GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI
KONTROLLIMI EKSTERN I DIJES NË FUND TË CIKLIT III TË SHKOLLËS FILLORE
PRILL, VITI MËSIMOR 2023-2024

njëfarë	asnjëfarë
---------	-----------

Nxënësi merr **1 pikë** për tri forma mohuese të sakta të fjalëve të dhëna.

DETYRA 16: është rrethuar numri: 2 – *nuk ka qime në gjuhë*

1 pikë

DETYRA 17: nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar: Rrinte hell në këmbë.

DETYRA 18: nxënësi merr **1 pikë** nëse nga fjalët e dhëna ka shkruar fjalët e reja:

hekur beton - **hekurbeton**
ditë shkurtër - **ditëshkurtër**
disa muajsh - **disamuajsh**

DETYRA 19: gjithsej **2 pikë**:

A) Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar: **Në mënyrën dëftore.**

B) Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar saktë numrin:
gjashtëdhjetë e nëntë

DETYRA 20: Skema e vlerësimit të hartimit **Lënda shkollore e preferuar**

Vërejtje: Pranohet edhe nëse nxënësi e ka shkruar hartimin ose ka filluar ta shkruaj në faqen e paraparë për shkrimin e planit të hartimit.

Përmbajtja – 10 pikë

Kërkesa 1.

Nxënësi merr 1 pikë nëse shkruan për raportin e tij ndaj shkollës, p.sh. përse e do shkollën/nuk dëshiron të shkoj në shkollë dhe ngjashëm.

Nëse jep një përgjigje më të plotë dhe më me stil, merr 2 pikë.

Gjithsej 2 pikë

Kërkesa 2.

Nxënësi merr 1 pikë nëse vetëm veçon lëndët të cilat janë me interes për të.

Gjithsej 1 pikë

GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI
KONTROLLIMI EKSTERN I DIJES NË FUND TË CIKLIT III TË SHKOLLËS FILLORE
PRILL, VITI MËSIMOR 2023-2024

Kërkesa 3.

Nxënësi merr 1 pikë nëse shkruan shkurt se çfarë mësohet në kuadër të lëndës së veçuar shkollore (p.sh. veprat letrare dhe gramatika; Jeta e bimëve, kafshëve, zhvillimit të njeriut; Ligjet e Njutnit, bëhen eksperimente të ndryshme...)

Për një përgjigje më të plotë merr 2 pikë.

Nëse jep një përgjigje më të plotë dhe më me stil, merr 3 pikë.

Gjithsej 3 pikë

Kërkesa 4.

Nxënësi merr 1 pikë nëse shkruan shkurt përse e do atë lëndë shkollore.

Nëse jep një përgjigje më të plotë dhe më me stil, merr 2 pikë.

Gjithsej 2 pikë

Kërkesa 5.

Nxënësi merr 1 pikë nëse shkruan për veçoritë e lëndës shkollore e cila do të mund të ishte interesante për nxënësit tjerë për ta mësuar (mundet edhe më shumë veçori).

Nëse jep një përgjigje më të plotë dhe më me stil, merr 2 pikë.

Gjithsej 2 pikë

Gjuha dhe struktura e tekstit - 8 pikë

Leksiku	Saktësia gjuhësore	Lidhshmëria	Struktura e tekstit
→ të shprehurit e qartë dhe të saktë, zgjedhja përkatëse e fjalëve, leksiku i pasur	<u>GRAMATIKA</u> → respektimi i normës gramatikore (përdorimi i drejtë i rasave, formave gramatikore,	→ renditja e natyrshme e të dhënave të ofruara, lidhshmëria e	→ përshtatja e organizimit të përgjithshëm dhe formës së tekstit

GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI
KONTROLLIMI EKSTERN I DIJES NË FUND TË CIKLIT III TË SHKOLLËS FILLORE
PRILL, VITI MËSIMOR 2023-2024

2 pikë → të shprehurit e qartë dhe të saktë, leksiku i varfër dhe përsëritja e shprehjeve pjesërisht e saktë 1 pikë	kongruencës) 2 pikë <u>DREJTSHKRIMI</u> → respektimi i normës drejtshkrimore (përdorimi i drejtë i shkronjës së madhe në fillim të fjalisë dhe i shenjave bazë të pikësimit, respektimi i rregullave për shkrimin bashkë dhe ndaras të fjalëve, si dhe për ndarjen e fjalëve në fund të rreshtit) 2 pikë Gjithsej 4 pikë <u>GRAMATIKA</u> → respektimi i normës gramatikore me gabime të vogla (p.sh. gabimet semantike...) pjesërisht e saktë - 1 pikë <u>DREJTSHKRIMI</u> → respektimi i normës drejtshkrimore me gabime të vogla (gabimet e vogla në shenjat e pikësimit: presja te fjalitë e	mirë në nivelin e tekstit dhe pjesëve të tij 1 pikë → s' është i lidhur në nivel të tekstit dhe pjesëve të tij 0 pikë	strukturës së tij logjike 1 pikë
--	---	---	---

GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

KONTROLLIMI EKSTERN I DIJES NË FUND TË CIKLIT III TË SHKOLLËS FILLORE
PRILL, VITI MËSIMOR 2023-2024

	ndërmjetme, inversioni, te fjalitë bashkërenditëse dhe nënrenditëse, respektimi i rregullave për shkrimin bashkë dhe ndaras të fjalëve, si dhe për ndarjen e fjalëve në fund të rreshtit) pjesërisht e saktë - 1 pikë Gjithsej 2 pikë		
--	--	--	--